


Raport

Hulumtim i opinionit publik për lojërat e fatit

Hulumtim kuantitativ

Janar 2017



Përmbajtja

Tema:	Faqet:
PËRSHKRIMI I STUDIMIT	3
GJETJET KRYESORE	5
SHPREHITË DHE INVESTIMI NË LOJËRA	7
NDIKIMI I LOJËRAVE	14
DEMOGRAFIA	18

Përshkrimi i studimit

Metodologjia

- **Tema:** Hulumtim i opinionit publik lidhur me dukurinë e varësisë nga lojërat e fatit
- **Universi në shënjestër:** Pjesëmarrësit në lojërat e fatit të Lotarisë së Kosovës, nëpër pikat e shitjes së Lotarisë, të moshës 18+ vjeçare
- **Qasja e studimit dhe metoda:** Hulumtim kuantitativ: Pyetësor i vetë-plotësuar nëpër pikat e shitjes pas blerjes së tiketave
- **Terreni:** 23 dhjetor 2016 - 20 janar 2017
- **Metoda e hulumtimit:** Mostra e rastit shumë-shkallëshe
- **Madhësia e mostrës:** 433 pyetësorë efektivë
- **Margjina e gabimit statistikor:** 4.7%
- **Instrumenti:** Pyetësori me kohëzgjatje rreth 5 minuta, i përpiluar në bashkëpunim me klientin.
- **Kontrolli i kualitetit:** Mbikqyrësit kanë vizituar pikat së paku 1 herë gjatë terrenit.

Gjetjet Kryesore

Gjetjet kryesore (1/2)

- **Loto, Telebingo** dhe **Lotari instant** radhiten top tri lojërat më të kërkuara të fatit. **Loto** del të jetë me përqindje më dominuese, ku vetëm 2% e respondentëve kurrë nuk luajnë atë. Interesim shumë i ultë shihet të jetë në **lojërat e kazinos ose pokerit në internet**.
- Nga përgjigjet e marra për shumën më të madhe të parave që ata kanë investuar në lojërat e fatit brenda një dite, më shumë se gjysma e respondentëve (53%) deklarojnë investimin prej **1 deri 10 EUR**. Ndërsa 32% e tyre kanë deklaruar shumën **10 deri 50 EUR**. Me përqindje dukshëm më të ultë radhiten shumat e tjera të parave mbi **51 EUR**.
- Shumica e respondentëve (59%) kanë deklaruar se nuk kanë investuar në lojë me më shumë të holla sesa kanë pasur qëllim. Gjithashtu ata nuk e kanë ndjerë nevojën për të zvogëluar sasinë e parave që e kanë investuar në lojërat e fatit (57%).
- Pothuajse gjysma e respondentëve pranojnë se lojërat e fatit i luajnë për **fitim material – në të holla**, ndërsa 43% luajnë për **argëtim**, dhe 11% **për të dëshmuar se sistemi i tyre i lojës sjellë fitim**.

Gjetjet kryesore (2/2)

- Pjesa më e madhe e respondentëve (77%) deklarojnë se nuk e kanë ndjerë ndonjëherë vetën fajtor për shumën e të hollave apo kohën që kanë investuar në lojërat e fatit.
- 12% e respondentëve deklarojnë se e kanë lënë ndonjëherë **punën apo shkollën** për shkak të lojërave të fatit. Megjithatë, pjesa më e madhe e tyre (82%) nuk e kanë ndjerë se pjesëmarrja në lojëra të fatit u krijon atyre çfarëdo lloj problemi, si konflikte në familje, përkeqësim të standardit jetësor, etj.

Shprehitë dhe investimet në lojëra


Shpeshtësia në lojërat e fatit

- Rezultatet tregojnë se lojërat e fatit i luajnë më së shpeshti **disa herë në javë** dhe **një herë në javë**.
- Top 3 lojërat më të kërkuara janë **Loto**, **Telebingo** dhe **Lotari instant**. Me përqindje më të lartë qëndron **Loto**, ku 41% e luajnë disa herë në javë, duke pasuar me 37% një herë në javë, dhe 8% disa herë në muaj. Për dallim nga lojërat e tjera, **Loto** thekësohet me vetëm 2% e respondentëve që nuk e luajnë kurrë.
- Me përqindje përgjysmë më të vogël se **Loto** radhiten lojërat **Telebingo**, dhe më pas **Lotari instant**.
- Interesim shumë i ultë tregohet **në Lojëra të kazinos ose pokerit në internet**, ku 89% e respondentëve nuk luajnë kurrë.

	Sa shpesh i luani këto lojëra të fatit?						
	Disa here në javë %	Një here në javë %	Disa herë në muaj %	Disa herë në vit %	Më rrallë %	Kurrë %	Pa përgjigje %
Loto	41	37	8	2	2	2	8
Lotari Instant	16	9	8	4	3	52	8
TeleBingo	24	21	4	2	1	40	8
Baste	11	3	4	1	3	70	8
Automate për lojëra të fatit	2	1	1	1	1	86	8
Lojë në kazino	2	0	0	0	1	89	8
Baste në internet	1	1	1	1	2	86	8
Lojë të kazinos ose pokerit në internet	1	0	0	1	1	89	8
Tjetër	1	1	-	-	-	91	-

Arsyet dhe qëllimet


- Pothuajse gjysma e respondentëve (49%) pohojnë se lojërat e fatit i luajnë për **fitim material – fitim në të holla**, dhe me përqindje të përafërt (43%) luajnë për **argëtim**. Ndërsa pjesa tjetër e respondentëve (11%) i luajnë lojërat e fatit **për të dëshmuar se sistemi i tyre i lojës sjell fitim**.



Shprehitë pas humbjes

- Respodentët që kanë luajtur lojëra të fatit në 12 muajt e fundit, më shumë se gjysma e tyre (52%) nuk ju ka ndodhë **asnjëherë** të luajnë përsëri një ditë tjetër, për të fituar atë që e kanë humbur më parë. Ndërsa me pëqindje të njejtë (18%) ata kanë luajtur prapë **çdo herë që kanë humbur**, dhe **ndonjëherë (gjysmën e rasteve që kanë humbur)**.
- 10% e respodentëve deklarojnë se ju ka ndodhë **shpesh** që të luajnë përsëri një ditë tjetër për të fituar atë që e kanë humbur më parë.


Nëse keni luajtur lojëra të fatit në 12 muajt e fundit, sa herë ju ka ndodhë të luani përsëri një ditë tjetër për të fituar atë që e keni humbur më parë?




Shprehitë në investim

- Më shumë se gjysma e respondentëve (59%) kanë deklaruar se ata nuk kanë investuar ndonjëherë në lojë më shumë të holla sesa kanë pasur qëllim.
- Gjithashtu me përqindje të përafërt (57%) nuk e kanë ndjerë ndonjëherë nevojën për të zvogëluar sasinë e parave që e kanë investuar në lojërat e fatit, ndërsa pjesa tjetër e tyre (41%) e kanë pohuar këtë.

A keni investuar ndonjëherë në lojë më shumë para sesa keni pasur qëllim?




A e keni ndjerë ndonjëherë nevojën për të zvogëluar sasinë e parave që e keni investuar në lojërat e fatit?



Shuma e investimit


- Më shumë se gjysma e respondentëve (53%) janë përgjigjur se shuma më e madhe e parave që kanë investuar ndonjëherë në lojërat e fatit brenda një dite të vetme është prej **1 deri 10 EUR**, duke pasuar me 17.3% me shumën prej **11 deri 20 EUR**, 8% e respondentëve me **21 deri 30 EUR**, dhe 3.4% e tyre me **41 deri 50 EUR**. Ndërkaq, një numër dukshëm më i vogël deklaruan që kanë investuar në lojëra të fatit me shumën mbi **51 EUR**
- Ndërkaq, mesatarja aritmetike (mean) tregon me shifër të lartë **58 EUR**, kjo sepse janë dy raste me 1.000 EUR dhe një rast 10.000 EUR nga përgjigjet e dhëna. Në këtë rast, pasqyrim më real tregon mediana **10 EUR** për shumën më të madhe që investojnë ndonjëherë në lojëra të fatit brenda një dite.

Sa është shuma më e madhe e parave që i keni investuar ndonjëherë në lojëra të fatit brenda një dite të vetme?



Detyrimet


- Në 12 muajt e fundit, 17% e respondentëve kanë pohuar se kanë marrë ndonjëherë para borxh për të luajtur lojëra të fatit ose për të kthyer borxhe për shkak të lojërave të fatit. Megjithatë, pjesa më e madhe e tyre (82%) deklarojnë se nuk e kanë bërë një gjë të tillë.



Ndikimi i lojërave

Ndikimi emocional


- Pjesa më e madhe e të anketuarve shprehen se nuk e kanë ndjerë ndonjëherë veten fajtor për shkak të shumës së të hollave ose kohës që e kanë investuar në lojërat e fatit (70%).




Ndikimi social

- Më shumë se gjysma e respondentëve kanë deklaruar që nuk kanë fshehur ndonjëherë nga njerëzit e tyre të afërt sesa investojnë në lojërat e fatit (61%).
- Gjithashtu në 12 muajt e fundit, më shumë se gjysmja nga ata (63%) nuk janë kritikuar prej dikujt ndonjëherë për lojërat e tyre të fatit, dhe 35% e tyre janë përgjigjur me Po, janë kritikuar më herët.

A keni fshehur ndonjëherë nga njerëzit tuaj më të afërt se sa investoni në lojërat e fatit?




A ju ka kritikuar dikush ndonjëherë për lojërat tuaja të fatit në 12 muajt e fundit?




Pengesat

- Shumica nga respondentët (86%) deklarojnë se në 12 muajt e fundit ata nuk e kanë lënë ndonjëherë punën ose shkollën për shkak të lojërave të fatit.
- Gjithashtu përqindje të lartë të respondentëve (81%) shprehen se ata nuk janë ndjerë ndonjëherë se pjesëmarrja e tyre në lojërat e fatit ju krijon atyre çfarëdo lloj problemesh, dhe 19% prej tyre janë përgjigjur se lojërat e fatit ju krijon atyre probleme, si konflikte në familje, përkeqësim të standardit jetësor, problem të komunikimit me njerëz tjerë, etj.

A e keni lënë ndonjëherë punën ose shkollën për shkak të lojërave të fatit në 12 muajt e fundit?



A keni ndjerë ndonjëherë se pjesëmarrja juaj në lojërat e fatit ju krijon çfarëdo lloj problemesh?




Demografia

Profili Demografik


Gjinia




Mosha



Shkollimi



Statusi i punësimit



FALEMINDERIT!

INDEXKOSOVA

©TNS 2017

